



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
K U V E N D I**

**L I G J
Nr.9949, datë 7.7.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9655, DATË 11.12.2006 “PËR
AKADEMINË E SHKENCAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9655, datë 11.12.2006, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Përzgjedhja e anëtarëve

Anëtarët e rregullt të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve të shquar me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve origjinale, veprave përgjithësuese, me një nivel të lartë shkencor, kanë zgjidhur, teorikisht dhe praktikisht, probleme të një rëndësie të veçantë në fushën e shkencës, të ekonomisë, artit dhe kulturës, si

dhe kanë dhënë ndihmesë në formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarë të rregullt të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve të shquar shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve dhe qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Në raste të veçanta, anëtarë të rregullt të Akademisë mund të zgjidhen edhe personalitete me merita të shquara në fusha të ndryshme të krijimtarisë.

Anëtarët e përhershëm të akademisë zgjidhen akademikët që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe kanë një kontribut të shquar, të vlerësuar gjerësisht, në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen nga radhët e shkencëtarëve me titull “Profesor”, që kanë ose kanë pasur shtetësi shqiptare, të cilët, nëpërmjet punimeve dhe veprave shkencore, kanë dhënë ndihmesë të rëndësishme në zhvillimin e shkencës dhe formimin universitar e pasuniversitar të shkencëtarëve të rinj. Anëtarët e asociuar të Akademisë zgjidhen edhe nga radhët e shkencëtarëve shqiptarë, që nuk e kanë fituar titullin “Profesor” në Shqipëri, por kanë gradën shkencore “PhD” ose “Doktor”, që punojnë aktualisht pranë universiteteve e qendrave kërkimore jashtë vendit dhe kanë kontribute akademike, që tejkalojnë parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi për kërkimin e titullit “Profesor”.

Anëtarët e nderit zgjidhen nga radhët e personaliteteve të njohura të vendeve të tjera, të cilët kanë dhënë kontribut të shquar në zhvillimin e vendit tonë.

Personat, që kanë funksione të larta administrative dhe politike, nuk mund të kandidojnë për tu zgjedhur anëtarë të rregullt dhe të asociuar të Akademisë gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve.

Procedurat për zgjedhjen e anëtarëve përcaktohen në statutin e Akademisë”.

Neni 2 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)